



Datë: 15.08.2025

Numër Protokolli: 5869/2025

A.nr.1257/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1257/2025, të datës 01.07.2025, të parashtruar nga ankuesi A.E , të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Qazim Hasanaj, nga Suhareka, kundër organit të punësimit/Komuna e Suharekës, në çështjen juridike “*pezullim nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1257/2025, e datës 01.07.2025, e parashtruar nga ankuesi A.E.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 01-Nr-016-32915, i datës 09.06.2025, i U.d Menaxher i Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.E (tutje referuar vetëm: *ankuesi*), më datë 27.06.2025, përmes përfaqësuesit Avokat Qazim Hasanaj, ka dërguar ankesën në Postën e Kosovës, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është regjistruar më datë 01.07.2025 dhe protokolluar me numër 4439/2025, kundër Vendimi me numër 01-Nr-016-32915, i datës 09.06.2025, i U.d Menaxher i Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm: *Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 23.07.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Suharekës, ndërsa, kjo e fundit më datë 23.07.2025 ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4439/2025 të datës 01.07.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimi me numër 01-Nr-016-32915, i datës 09.06.2025, i U.d Menaxher i Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës; Procesverbali i shqyrtimit fillestar i datës 28.05.2025 i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të

Rënda; Aktvendimi i datës 28.05.2025; pliko postare e datës 27.06.2025; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 23.07.2025; Përgjigje në ankesë e datës 23.07.2025 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 07.12.2012; Akt Emërimi me Nr.112-2080 i datës 09.01.2025; Aktvendimi i datës 28.12.2011; Njoftim i datës 28.05.2025; Aktakuzë PP/1 nr.36/23 të datës 30.04.2025 i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se rastin e ankuesit, është e pabazuar, **sepse**:

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit me Nr.112-2080 i datës 09.01.2025, mban pozitën e punës Zyrtar për Menaxhimin e Projekteve/ në kuadër të Drejtorisë për Arsime në Komunën e Suharekës.

Me tej sipas shkresave të lëndës, se me Vendimi me numër 01-Nr-016-32915, i datës 09.06.2025, i U.d Menaxher i Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës., ka pezulluar ankuesin nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës deri në përfundimin e procedurës penale apo nxjerrjen e vendimit tjetër

Ankuesi në ankesën e parashtruar për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimi me numër 01-Nr-016-32915, i datës 09.06.2025, i U.d Menaxher i Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës.

, pretendon se ky vendim është nxjerrë përmes konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, si rrjedhojë propozon aprovimin e ankesës, shfuqizimin e aktit kontestues si dhe lejimin e rikthimit të së njëjtës në vendin e tij të punës, me kompetenca të plota sipas akt emërimit të lartë shënuar,

Kolegji i Këshillit, lidhur me çështjen e pezullimit të marrëdhënies së punës, ju referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht:

- Nenit 68 paragrafi 1, përcakton se: *“1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil që bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; 1.2. me kërkesë të nëpunëses/it civil”.*
- Nenit 69 paragrafi 1 dhe 2, kanë përcaktuar se: *“1. Nëpunësja/i civil pezullohet sipas detyrës zyrtare, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 4. të nenit 59 të këtij ligji; 1.2. kur emërohet në një nga funksionet e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 3 të këtij ligji, për periudhën përkatëse të emërimit; 1.3. transferohet, për nevoja të institucionit, në një organizatë ndërkombëtare apo në një institucion ndërkombëtar, për periudhën përkatëse; 1.4. kur gjykata pezullon nëpunësen/in civil që është person zyrtar nga ushtrimi i detyrës, për kushtet dhe shkaqet të parapara në legjislacionin përkatës në fuqi; 1.5. ndaj nëpunëses/it civil është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të saj/tij; 1.6. nëpunësja/i civil, mbahet në arrest në pritje të vendimit të formës së prerë; 1.7. deklarohet e/i zhdukur me vendim të formës së prerë të gjykatës, deri në shfaqjen e personit apo deklaramit të vdekjes me vendim të formës së prerë të gjykatës; 1.8. regjistrohet apo zgjidhet, sipas ligjit, si kandidate për zgjedhjet qendrore e lokale, sipas nenit 25 të këtij ligji; 1.9. ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi, sipas ligjit të veçantë, deri në transferimin e saj/tij në një pozitë tjetër, në përputhje me nenin 64 të këtij ligji; 1.10. gjatë ndjekjes së ndonjë programi arsimimi apo trajnimit më të gjatë se tridhjetë (30) ditë, për nevojat e institucionit, për periudhën që ndjek këtë program me shkëputje nga puna; 1.11. në raste të tjera, të parashikuara shprehimisht me ligj. 2. Përveç kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj, konstatimi i shkakut të pezullimit bëhet nga: 2.1. NjMBNj e institucionit, ku nëpunësja/i ushtron detyrën”.*

- Neni 71 paragrafi 8 dhe 9, ka përcaktuar se: “8. Nëpunësja/i civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1., nën-paragrafët 1.4., 1.5., 1.6. dhe 1.7. të nenit 69 të këtij ligji, nëpunësja/i civile përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtesë në pagë, deri në fund të periudhës së pezullimit. 9. Në rast se procedura disiplinore apo procedura penale përfundon pa një masë disiplinore, gjegjësisht dënim penal, nëpunëses/it civil që ka qenë e pezulluar me pesëdhjetë për qind (50%) të pagës së saj/tij, i kompensohet pjesa e ndaluar e pagës bazë”.

Andaj, referuar kuadrit ligjor si më lartë si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, konstatohet se Prokuroria Themelore në Prizren ka parashtruar aktakuzë PP/1 nr.36/23 të datë 30.04.2025, dhe se kjo procedurë sipas e-mailit të datës 28.02.2025, të zyrtares kompetente të Prokurorit të Shtetit-Prokuroria Themelore në Prizren , e dërguar tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës, konfirmohet se është ende në fazën e hetimeve, si rrjedhojë dhe duke u bazuar mbi këto rrethana ligjore, Kolegji i Këshillit, erdhi në përfundim se Vendimi me numër 01-Nr-016-32915, i datës 09.06.2025, i U.d Menaxher i Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës, është nxjerrë në pajtim me nenin 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ngase nëpunësi civil pezullohet sipas detyrës zyrtare në rastet kur ndaj tij është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, kështu që, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1257/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabsni

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A.E;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.